



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 181/2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, kështu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 17.06.2012, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se LVV ka thyer rregullat e zgjedhore duke vendosur poster mbi rrugë publike, siç potencon ankuesi duke i lidhur ato tejpërtej rrugës dhe atë në hyrje të shkollës “Skënderbeu” më afër se 100 m nga Qendra e Votimit, ashtu siç është paraqitur edhe në fotografimin nr 1 dhe 2 të bashkangjitur në ankesë. Mëtej parashtruesi i ankesës thekson se dhe në rrugën, Bulevardin “Ismajl Raka” është vendosur poster, përsëri duke prerë rrugën tejpërtej, siç shihet në fotografimin numër 3 të bashkangjitur në ankesë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës fotografitë me numër një, dy dhe tre si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LVV, nëpërmjet email-it më datë 17.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.181/2, PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LVV lidhur me ankesën Anr 181, të paraqitur nga subjekti politik PDK, ku në përgjigjen në ankesë subjekti politik LVV potencon se Lëvizja Vetëvendosje ka respektuar në përpikmëri

rregulloren dhe ka largur banerin e vendosur në këtë vend brenda periudhës së caktuar, përkatësisht 30 orë para hapjes së Qendrave të Votimit

Lëvizja Vetëvendosje pretendon se ankesa është e pabazë, sepse së pari ajo çfarë ka qenë e vendosur ka qenë një banerë dhe jo një poster apo mbishkrim dhe ky banerë nuk ka qenë i vendosur në hyrje të shkollës, por ka qenë i kapur në dy shtylla mbi rrugën që kalon afër Gjimnazit “Skënderbeu”, dhe siç potencon subjekti politik LVV se baneri ynë ka qenë i vendosur në këto dy shtylla vetëm deri më datë 15.06.2012, pasi që ne e kemi hequr këtë baner 30 orë para hapjes së Qendrës së Votimit. Gjithashtu subjekti politik LVV në përgjigje në ankesë thekson se në pjesën e dytë të ankesës lidhur me banerin tonë të vendosur në Bulevardin tonë “Ismajl Raka” është gjithashtu e pabazuar, pasi që sipas subjektit LVV ky baner ndodhet 300 metra larg Qendra të Votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Parashtruesi ankesës thekson se subjekti politik LVV, kanë vendosur banerë mbi rrugë publike, gjegjësisht në hyrje të shkollës “Skenderbeu” më afër se 100 metra nga Qendra e Votimit dhe në rrugën, Bulevardin “Ismajl Raka”, andaj PZAP-i, nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës të kësaj ankese vërtetoj se baneri i subjektit politik LVV, është i vendosur mbi rrugë publike, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 3.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së e cili përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, banerave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Ndërsa sa i përket çështjes se posterit në fjalë është i vendosë më afër se 100 metra nga QV, PZAP-i nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP- konstatoi nga dëshmit e ofruara se se nga ana e subjektit politik LVV, është shkelur neni 3 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2009 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga fotografitë e ofruara si dëshmi që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për Kryetar të Komunës së Kaçanikut nga radhët e subjektit politik LVV është vendosur mbi rrugë publike. Prandaj nga të gjitha arsyet e lartshënuara si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 181/2012 më datën 18.06.2012.

